



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency



Data: 15/09/23 Ref.: 1209/23

Në mbështetje të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), nenit 8 dhe 14 të Ligjit për Organizimin dhe Funksonimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura të Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (GZ, Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ, Nr.20/12 qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë,(përditësuar me vendimin Ref.932/22), Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC), në mbledhjen e 115-të, të mbajtur më 25.08.2023, mori:

#### V E N D I M

- I. Validohet akreditimi/riakreditimi ndërkombëtar i Kolegjit Heimerer për periudhën pesë (5) vjeçare (1 tetor 2023 – 30 shtator 2028), për programet e studimit:
  1. *Shkenca Shëndetësore për Profile Diagnostike-Teknik Laborator, BSc, 180 ECTS, (R), me kuotën, maksimumi 60 studentë për vit akademik;*
  2. *Kujdesi Shëndetësor Dixhital, MSc, 120 ECTS, (A), me kuotën, maksimumi 40 studentë për vit akademik;*
  3. *Psikologji, BSc, 180 ECTS, (A), me kuotën, maksimumi 80 studentë për vit akademik;*
  4. *Psikologji Klinike, MSc, 120 ECTS, (A), me kuotën, maksimumi 50 studentë për vit akademik;*
- II. Obligohet Kolegji Heimerer që deri më datë 15.11.2023 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit.
- III. Obligohet Kolegji Heimerer të raportoj dhe arsyetoj çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Lista me ndryshimin e bartësve aprovohet me vendim nga KSHC.
- IV. AKA rezervon të drejtën e aplikimit të dispozitave të nenit 21 të Udhëzimit Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, kurdo që vlerëson të arsyeshme dhe të nevojshme.
- V. Institucioni i Arsimit të Lartë si në pikën I, mbanë përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

## ARSYETIM

Kolegji Heimerer ka parashtruar kërkesë me Nr.prot.924/23 me datë 11.07.2023 në Agjencisë së Kosovës për Akreditim, për validimin e të akreditimit/riakreditimit të programeve të studimit të cekura në paragrafin I të dispozitivit të këtij vendimi.

Kërkesa dhe materialet e nevojshme për shqyrtim i janë dorëzuar me kohë KShC-së dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit të nevojshëm për validim KShC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Periudha pesë vjeçare është kufizuar bazuar në nenin 19 të Udhëzimit Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018).

Vendimi është marrë duke ju referuar Udhëzimit Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), si dhe duke ju referuar raporteve, certifikatave dhe dëshmime të ofruara, rreth akreditimit të këtij institucioni nga Agjencia EVALAG (Gjermani), e cila është anëtare e Asociacionit Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA).

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi pala mund të parashtrroj ankesë sipas Ligjit Nr.05/L-031 mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative në organin që ka nxjerrë këtë vendim, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar. Inicimi i konfliktit administrativ apo çfarëdo procedure tjetër administrative nuk e pengon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Kolegjit Heimerer;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.

  
Prof. Asoc. Dr. Huseina Ilazi  
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

